

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Spring 5-2020

### KONTRATA DHE PASOJAT JURIDIKE TE MOS ZBATIMIT TE SAJ

Ardena Rama

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Rama, Ardena, "KONTRATA DHE PASOJAT JURIDIKE TE MOS ZBATIMIT TE SAJ" (2020). *Theses and Dissertations*. 1639.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1639>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

**KONTRATA DHE PASOJAT JURIDIKE TE MOS ZBATIMIT TE SAJ**  
Shkalla Bachelor

Ardena Rama

Maj 2020

Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti Juridik

Punim Diplome  
2013/2014

Ardena Rama

**KONTRATA DHE PASOJAT JURIDIKE TE MOS ZBATIMIT TE SAJ**

Mentori: Artan Qerkini

Maj 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor

## ABSTRAKT

Kontrate quajmë pajtimin e vullnetit në mes të dy apo më shumë personave me qëllim të krijimit të efekteve juridike. Me kontrate konstituohen detyrimet. Me kontrate arrihet efekti i ndryshimit të një raporti detyrimor. Me kontrate arrihet efekti i shuarjes së detyrimit.

Që të ekzistoj një kontrate duhet të përmbajë: pëlqimin e vullnetit; të ekzistoj objekti i kontraktimit; dhe të ekzistoj baza e kontraktimit. Raporti detyrimor është raport juridik ( i cili fiton të drejtën të kërkoj ) dhe debitorit ( i cili merr detyrim ta përmbush një kërkesë). Kur debitori nuk reagon ndaj kërkesës së kreditorit apo kur në mënyra tjera i ik përmbushjes së detyrimit, kreditori ka mundësi që detyrimin ta përmbush duke përdorur të drejtën e ngritjes së padise, pra duke përdorur mjetet juridike dhe fuqinë e shtetit. Kundërshtimi i veprimit juridik të debitorit – Një ndër instrumentet kryesore për mbrojtje të debitorit është instituti i sulmimit të punëve juridike të debitorit. Veprimi i debitorit mund të sulmohet qoftë me padi qoftë me kundërshtim. Por për këtë duhet të plotësohen edhe kushtet e caktuara. E drejta e mbajtjes – Mbajtja e sendit të debitorit, kur ai bi në duar të kreditorit, paraqet një mjet sigurimi për kreditorin. Kreditori ka te drejte ta mbaj ate send deri ne permbushjen e detyrimit nga ana e debitorit. Gjithashtu në vendet ku dominon parimi i të drejtës në punë është i institucionalizuar edhe parimi që punëtorit nuk mund ti shkëputet kontrata e punës apo ti ndërpritet marrëdhënia e punës pa dëshirën e tij. Por legjislacionet e punës i kanë paraparë edhe rastet e shkëputjes së kontratës së punës edhe kundër dëshirës së tij, kur për këtë paraqiten rrethanat e caktuara. Sipas dispozitave të rregullores për ligjin themelor të punës në Kosovë, shkëputja e kontratës së punës mund të bëhet në disa mënyra. Gjithçka në Kontrat të punës është e caktuar, dhe gjithçka është caktuar ligjërisht. Angazhimi i politikave të ligjbërësve për integrimin e legjislacionit me normat bashkëkohore europiane, përvetëson edhe të drejtën familjare, duke përfshirë edhe institute të reja në ligj.

## **MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME**

Ky punim është realizuar falë ndihmesës së jashtëzakonshme të mentorit tim dhe familjes për të cilët ndjej detyrimin t'i falenderoj me shumë respekt. Rreshtat e parë të falenderimeve shkojnë për mentorim tim njëkohësisht udhëheqësin tim të parë të këtij punimi, Prof. Dr. Artan Qerkini, i cili ka bërë një punë të palodhshme dhe ka qenë ndihmesë në vazhdimësi deri në përfundimin e kësaj teme.

Këshillat e tij metodike dhe profesionale kanë qenë të domosdoshme, ndërsa mbikqyrja e tij më ofroi mundësi dhe më pasuroi me një gamë të gjërë të informacioneve rreth temës

Dëshiroj të falenderoj gjithashtu Departamentin të Fakultetit Juridik për mirëkuptimin e treguar. Falenderime të veçanta ju shpreh familjarëve të mi, për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë.

Janar 2020

Prishtinë

# PËRMBAJTJA

## 1 PËRMBAJTJE

1	HYRJE .....	1
1.1	Cka jane kontratat dhe pasojat juridike .....	11
2	SHQYRTIMI I LITERATURËS .....	3
2.1	Llojet e kontratave.....	5
2.2	Mënyra e lidhjes së kontratës.....	10
2.3	Kushtet për vlershmërinë e kontratës.....	14
2.4	Shkëputja e kontrates.....	17
2.5	Shkeputja e kontrates me marreveshje te paleve .....	17
2.6	Shkeputja e kontrates ne menyre te njeanshme.....	19
2.7	Shkeputja e kontrates per shkak te ndryshimit te rrethanave(Klauzola rebus six stantibus).....	22
2.8	Shkeputja e kontrates kur afati eshte elementi esencial i kontrates.....	23
2.9	Pasojat juridike të shkëputjes së kontrates.....	24
2.9.1	Mënyra se si përlogaritet dëmi kontraktues.....	25
2.9.2	Fitimi i munguar(i humbur) si pasojë e mospërbushjes së kontratës.....	27
3	DEKLARIMI I PROBLEMIT .....	29
4	METODOLOGJIA .....	30
5	PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE .....	31
5.1	Prezantimi i rezultateve.....	31
5.2	Analiza e rezultateve.....	31
6	KONKLuzionet.....	32
7	REFERENCAT.....	34

# 1 HYRJJE

*Në këtë kapitull do të paraqitet një pamje e përgjithshme në pika të shkurta për punimin dhe qëllimin e këtij punimi. Me fjalë të tjera, do të paraqitet pyetja hulumtuese për të ilustruar fokusin kryesor, si dhe rëndësinë e këtij hulumtimi.*

*Cka janë kontratat dhe cilat janë pasojat juridik.*

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj. Kontrata ka efekt ndaj të tretëve në rastet e parashikuara me ligj. Efektet juridike të kontratës shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe. Kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Kontrata është vepër e palëve kontraktuese. Ajo lidhet me pajtimin e vullnetit të shprehur të dy ose më shumë subjekteve me qëllim të krijimit, ndryshimit ose shuarjes së marrëdhënies së caktuar të detyrimeve.

Interpretimi i kontratës do të thotë përcaktimi i kuptimit të vërtetë dhe efekteve të dispozitave të saj. Në qoftë se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të vullnetit të palëve, vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë. Përfundimi i kontratës është një veprim që mund të ndodhë kur një kontratë mund të përfundojë me ligj para se të përmbushen detyrat kontraktuale. Palët mund të zgjedhin të përfundojnë kontratat për një sërë arsyesh, por jo të gjitha përfundimet e kontratave do t'i lejojnë ata të shpëtojnë nga përgjegjësia.

Sidoqoftë, disa raste të përfundimit të kontratës do të rezultojnë në anulimin e kontratës në tërësi. Përfundimi i kontratave rregullohet nga ligjet e kontratave, që do të thotë se ligji mund të ndryshojë në varësi të shtetit tuaj dhe juridiksionit tuaj.

## 2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

*Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë dhe logjike, ku është shqyrtuar literatura që përfshinë konceptin e kontratave, llojet e kontratave, mënyrën e lidhjes së kontratës, shkëputjen e kontratës, shkëputjen e kontratës me marrëveshje të palëve, shkëputja e kontratës në mënyrë të një anëshme, shkëputja e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave (klauzola rebus six stantibus), shkëputja e kontratës kur afati është element esencial i kontratës të cilat të gjitha këto do t'i shtjellojme me gjerë.*

### 2.1 Llojet e kontratave

Liria e rregullimit të marrëdhënieve kontraktuese ka mundësuar krijimin e kontratave të shumta dhe të shumëllojshme. (Vermelle, 2019)

Kriteret për klasifikimin e kontratave janë të ndryshme: Duke pasur parasysh faktin se një kontratë a është e parapare sipas ligjit apo jo, kontratat klasifikohen:

**1.Kontrata e emëruar** (Ukudu el musemma) është ajo kontratë që është e parapare dhe e rregulluar shprehimisht nga ligjdhënësi përmes dispozitës ligjore dhe i ka venduar emër të veçantë, siç është kontrata e shitblerjes, kontrata e qirasë, kontrata e këmbimit, etj.

**2.Kontrata e pa emëruar** (ukud gajru musemma) është ajo kontratë që ligjdhënësi nuk ka rregulluar shprehimisht e as që i ka venduar emër, siç është kontrata e ekspozimit, kontrata e botuesit me autorin, kontrata për angazhime hotelerie etj. Këto lloje të kontratave arrihen duke u bazuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktuese.

Sipas kushteve të domosdoshme që nevojiten për krijimin e tyre se kontrata a lidhet në bazë të vullnetit të palëve-soloconsensus apo në bazë të formës së caktuar (Vermelle, 2019), kontratat klasifikohen:

**1.Kontratë konsensuale** (ukud ridaije), e që është kontrata e cila lidhet në mbështetje të vullnetit dhe dëshirës nga dy palët kontraktuese, dhe

**2.Kontratë formale** (ukud sheklje) janë kontratat të cilat krahas vullnetit të dy palëve kontraktuese, ajo kontratë për lidhjen dhe vlefshmërinë e saj, me ligj është përcaktuar edhe forma



e sajë, pra duhet patjetër të bëhet në formë të veçantë, që nënkupton se për lidhjen e kësaj kontrate nuk mjafton vetëm vullneti i palëve kontraktuese, por forma është element konstituiv i kësaj kontrate.

Nëse kontratën e kundrojmë nga aspekti i detyrimeve që dalin nga palët kontraktuese (Vermelle, 2019), atëherë kontrata mund të jetë:

**1. Kontratë detyruese e njëanshme**, (unilaterale) janë ato kontrata nga të cilat dalin detyra vetëm për njërën palë kontraktuese, ngase vetëm njëra palë bëhet debitor. Si kontrata të njëanshme detyruese (unilaterale) janë, kontrata mbi dhuratën, kontrata e huas etj.

**2. Kontratë detyruese e dyanshme**, (bilaterale) janë ato kontrata që formon të drejta dhe obligime për të dy palët kontraktuese. Kontrata të tilla janë kontrata e shitblerjes, kontrata e qirasë, kontrata mbi veprën, kontrata e ortakërisë etj.

Duke pasur parasysh se njëra palë për atë, që ka dhënë a merr kundervlerë adekuate apo jo, kontratat klasifikohen:

**1. Kontrata me shpërblim**-në këto kontrata jepet shpërblimi për atë që merret. Në këtë grup kontratash hyjnë: Kontrata mbi shitjen, mbi veprën, mbi ortakërine, mbi qiranë, mbajtjen e përjetshme, mbi ndërtimin.

**2. Kontrata pa shpërblim**-janë ato kontrata në të cilat nuk jepet kurrëfarë shpërblimi për atë që fitohet. Në këto kontrata hyjnë: kontrata mbi dhuratën, huanë pa kamatë, kontrata mbi shërbimin, kontrata mbi depoziten.

Sipas asaj se me rastin e lidhjes së kontratës a i dinë palët kontraktuese, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe se a varet kjo nga rrethanë e ardhshme dhe e pasigurt, kontratat klasifikohen në:

**1. Komutative**-janë ato kontrata në të cilat palët kontraktuese që në çastin e lidhjes së kontrates i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në këto kontrata hyjnë: kontratat mbi shitjen, këmbimin, ndërtimin, sigurimin, qiranë, ortakërine etj.

**2.Aletore**-janë ato të drejta në të cilat palët në çastin e lidhjes së kontratës nuk i dinë të drejtat dhe detyrat e tyre,por kjo nuk varet nga një rrethanë e ardhshme dhe e pasigurtë. Në këtë grup hyjnë: kontrata mbi sigurimin,kontrata mbi lojen dhe kushtin, kontrata mbi mbajtjen e përzetshme.

Sipas kohëzgjatjes së prestimit që duhet të përmbushet, kontratat klasifikohen në kontrata me:

**1.Prestime të përhershme** –janë ato, në të cilat ekzekutohen me intervale më të gjata kohore.Në këto kontrata detyra e debitorit përbëhet prej shumë bërjesh,mos bërjesh ose lëshimesh,p.sh, kontrata mbi qiranë,pagesa mujore etj.

**2.Prestime të përkohëshme**-janë ato në të cilat prestime ekzekutohen aty për aty, mënjëherë.Detyrimi i debitorit përbëhet prej një bërje ose mosbërje,prej një lëshimi të cilin ekzekuton për një çast.p.sh Kontrata e shitjes së sendeve me para të gatshme.

Sipas asaj se në një kontrat a janë elementet e një kontrate apo ka elemente të disa kontratave, kontratat klasifikohen në;

**1.Të thjeshtë** -janë ato që kanë elemente të një kontrate, dhe paraqet një lloj të caktuar kontratash(psh,kontrata e shitjes, e qirasë, e depozitës, e dhuratës, e këmbimit etj.)

**2.Të përziera** -është një kontratë, e cila sipas përmbajtjes ka elemente të disa kontratave të thjeshta.Përmbajtja e këtyre kontratave paraqet një tërësi të një kontrate unike.

Kontratat e përziera janë: kontrata mbi pensionin,kontrata mbi sefin,kontrata mbi allotmanin,kontratat mbi injeneringun.

Në bazë të mënyres së lidhjes së tyre kontratat klasifikohen në:

**1.Të përgjithshme** -janë ato kontrata të cilat palët i kanë caktuar,saktësuar,të drejtat dhe detyrimet në mënyre të përgjithshme, për një periudhë të gjatë kohore.Këto kontrata zakonisht lidhen në ndërtimtari për ndërtimin e urave,rrugeve,fabrikave etj.

**2.Të veçanta** -janë ato kontrata të cilat lidhen për çdo vite kalendarik, ku caktohen punët e ndërtimit për atë vit.Janë këto kontrata në të cilat janë konstatuar detyrat konkrete të palëve për një periudhe të shkurter prej një viti.

Duke pasur parasysh faktin se një kontrate a mund të ekzistojë pavarësisht nga ekzistimi i saj apo varet nga ndonjë kontratë tjetër, kontratat klasifikohen në kontrata:

**1. Të pavarura** -janë kontrata që krijojnë efekte juridike dhe shuhen pavarësisht nga ndikimi i ndonjë kontratë tjetër.

Kontratat e pavarura janë: kontratat e shitjes, ortakerisë, qirasë, e veprës, e shërbimit, e dhuratave etj.

**2. Akcesore** -janë kontrata që lidhen, ekziston dhe varet nga kontrata kryesore. Zakonisht këto kontrata lidhen si shtesë e kontratës së pavarur ose e kontratës së veçantë por akcesore. Kontratat akcesore janë: kontratat për dorëzimin, pengun, hipotekën, kuacionin, pendimin. Kontratat akcesore më së shumti lidhen për ekzekutimin e kontratës.

Duke u bazuar në faktin se një kontratë a lidhet me qëllim që të lidhet një kontratë tjetër, kontratat klasifikohen në:

**1. Parakontratë** -janë ato kontrata me anë të së cilave palët janë të obliguar që në të ardhmen të lidhin kontratë tjetër, elementet e të cilave janë caktuar më parë. Forma e parakontratës varet nga forma e kontratës kryesore që do të lidhet, në rast se forma është kusht i vlefshmërisë së kontratës.

**2. Kontrata kryesore** -janë ato kontrata të cilat krijohen pasi të jetë përmbushur kontrata paraprake. Nuk mund të zbatohen në kontratë paraprake rregullat mbi përgjegjësinë për mungesat fizike dhe juridike të sendeve.

Se a merren parasysh cilësitë e veçanta të palës kontraktuese apo jo, kontratat klasifikohen në:

**1. Kontrata intuitu personale** -janë ato kontrata për lidhjen e të cilave merret parasysh cilësia e veçantë e palës kontraktuese. Si cilësi e veçantë konsiderohen: talenti, mjeshhtëria e veçantë, besimi i caktuar, afiniteti ndaj një personi. Kontrata personale shuhet me vdekjen e palës, vetitë e veçanta të së cilës janë marrë parasysh për lidhjen e kontratës.

**2. Jo intuitu personale (Personale dhe jo personale)** -janë ato kontrata në të cilat nuk merret parasysh cilësia e veçantë e palës kontraktuese (psh. kontrata e shitjes, këmbimit, etj)

Se në lidhjen e kontratës a marrin pjesë drejtëpërdrejtë të gjithë subjektet që kanë shprehur vullnetin apo një person e lidh kontratën në emër të tyre, kontratat klasifikohen në:

**1. Individuale** -janë ato kontrata më të cilat saktësohen detyrat ndërmjet subjekteve/anëtareve të grupit në emër të cilave është lidhur kontrata kolektive. Rastet më të shpeshta janë: kontrata individuale e punës që lidh punëtorët me punëdhënësit

**2.Kolektive** -janë ato kontrata që krijojnë efekte juridike për të gjithë subjektet që i përkasin grupit të caktuar, pa marrë parasysh se të gjithë nuk kanë dhënë pëlqimin për lidhjen e saj.Këtu hyjnë: kontratat kolektive e punës, kontrata e sigurimit kolektiv, pajtimi me dhunë i kreditorëve.

Sipas teknikes dhe mënyrës së lidhjes së tyre,kontratat klasifikohen në kontrata me:

**1.Përmbajtje të caktuar** -janë ato kontrata, në të cilat është e caktuar përmbajtja nga palet kontraktuese.Në këto kontrata palët me marrëveshje i caktojnë elementet dhe kushtet e saj.

**2.Kontrata të adezionit** -janë ato kontrata, në të cilat njëra palë që me përpara i cakton elementet dhe kushtet e kontratës, kurse pala tjetër nuk merr pjesë në përpilimin e kësaj kontrate e as që ndikon në ndonjë element të këtyre kontratave.Në këto kontrata paraqiten në kontratat mbi transportin e mallrave,në hekurudha,në trafikun ajror,ujor,në lemin e sigurimit, në shërbimet postale, në shërbimet komunale etj.

Varësisht se një kontratë a duket baza apo nuk duket,kontratat klasifikohen në:

**1.Kuazale** -janë kontrata të cilat shkak i drejtëpërdrejtë juridik për çka është lidhur kontrata është i njohur,jo vetëm për palët kontraktuese,po edhe për personat e tretë.

Këtu bëjnë pjesë: kontratat mbi dhuratën, huanë, depozitën, qiranë,vepren etj.

**2.Abstrakte** -janë ato kontrata të cilat nuk është cekur qellimi për të cilën palët obligohen.Baza e kontratës ekziston në këto kontrata por shkak është i njohur për palët kontraktuese sepse obligohen.

Kontrata abstrakte është kombiali,ose kur dikush obligohet me shkrim se dikujt do t'ia paguaj shumën e caktuar të parave. (*Vermelle, 2019*)

## 2.2 Mënyra e lidhjes së kontratës

Kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës janë:

- Aftësia punuese zotësia juridike e palëve kontraktuese
- Pajtimi i vullnetit,
- Lënda e kontratës
- Baza e kontratës
- Aftësia e plotë për të vepruar
- Aftësia e kufizuar për të vepruar
- Paaftësia e plotë për të vepruar

Nga palët të cilat lidhin kontrat duhet të jetë edhe pëlqimi i vullnetit.

Vullneti duhet të jetë:

- Serioz
- Të bëhet lirisht
- Të jetë i vërtetë
- Të jetë i mundshëm

Vullneti është serioz kur shpreh qëllimin e deklaruesit se dëshiron të lidhe kontratën. *(Nani, 2009)*.

Vullneti është i vërtetë nëse palët kontraktuese e kanë shprehur atë dhe në rast se ai është vullnet i tyre. Vullneti është i lirë kur nuk është manifestuar nën ndikimin e mashtrimit, kërcenimit ose dhunës. Vullneti është i mundshëm nëse me anë të kontratës që do lidhet do të realizohet një qëllim i mundshëm *(Vermelle, 2019)*.

Pas pëlqimit të vullnetit vjen lënda e kontratës. Lënda e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Lënda e kontratës është ajo për të cilën palët janë marrë vesh ose për çka është lidhur kontrata. Lëndet e kontratës mund të jetë ndonjë send, veprim, mosveprim. Lënda e kontratës konsiston në sjelljen që duhet të mbajë debitori ndaj kreditorit. Detyrimi kontraktues mund të përbëhet nga dhënia, bërja mos bërja ose durimi. Ai duhet të jetë i mundshëm i caktuar i lejuar respektivisht i caktueshëm. Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm i caktueshëm ose që mund të përcaktohet. Lëndet e kontratës mund të jetë sendi i luajtshëm i paluajtshëm dhe sendi i konsumueshëm *(Nani, 2009)*.

Sa i përket bazës së kontratës, tek baza është kusht i përgjithshëm për lidhjen e saj. Bazë e kontratës është qëllimi juridik që e ka shtyrë ndonjë subjekt të marrë detyrimin dhe që e ka caktuar karakterin

juridik të punës. Bazë e kontratës është shkaku, arsyeja për të cilën debitori merr detyrimin. Në terminologjinë juridike, përveq termit bazë, përdoren edhe termet, shkaku, titulli juridik (*Vermelle, 2019*). Përveq kushteve të përgjithshme të kontratës për lidhjen e kontratës duhet të përmbushen edhe kushtet e veçanta të cilat janë:

***-Lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit***

***-Dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës***

***-Forma e kontratës***

Forma e kontratës është manifestim i jashtëm i përmbajtjes së kontratës. Parimi bazë që ka karakterizuar të drejtën civile në përgjithësi dhe të drejtën e detyrimeve në veçanti, është ai i lirisë së formave (*Nani, 2009*). Kjo do të thotë se palët për shfaqjen e vullnetit të tyre në një marrëdhënie juridike, janë të lirë që të përdorin çdo formë që është e përshtatshme për ta nxjerrë në pah këtë vullnet (*Vermelle, 2019*).

Forma e kontratës mund të jetë:

***-Solemne***

***-Reale***

***-Provuese***

***-Me shkrim***

***-Ligjore***

***-Kontraktore***

Forma solemne është formë thelbësore dhe element konstituiv i kontratës.

Forma reale ekziston në ato raste kur dorëzimi i sendit është kusht i veçant për krijimin e disa kontratave (*Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, Ligji nr. 03/L-154*).

Forma provuese shërben si provë për vërtetimin e ekzistimit të kontratës në rast kontesti ndërmjet palëve kontraktuese.

Forma me shkrim e kontratës është formë e tillë ose redaktimi me shkrim i kontratës i shkruar me dorë, me makinë dhe e nënshkruar nga palët kontraktuese që e kanë lidhur kontratën (*OSBE, 2011*).

Forma ligjore ekziston kur për vlershmërinë e një kontratë ligji shprehimisht e parasheh formën e caktuar (*Nani, 2009*).

Forma kontraktore ekziston kur palët kontraktuese për vlershmërinë e kontratës parashohin formën e caktuar.

Palët kontraktuese mund të merren vesh që forma të jetë kusht i veçant për vlershmërinë e kontratës së tyre. (*European Parliament, 2012*)

Për lidhjen e kontratave:

- **Negociatat**
- **Oferta**
- **Vendi dhe koha e lidhjes së kontratës**
- **Parakontrata**

Termi "negociatim" origjinon nga latinishtja me kuptimin e "Biznesit" apo të punës së leverdishme në të cilën nuk ka elemente të parazitizmit".Negocimi është diskursi apo këmbimi i komenteve për të vendosur një interes të përbashkët në funksion të bërjes së biznesit të caktuar.Lidhjes së kontratës i paraprinë bisedimet midis subjekteve të caktuara.Subjektet e interesuara mund të bisedojnë për elementet e caktimit të lartesisë së çmimit,për mënyrën dhe vendin e dërgimit,për cilesinë e sendit,për pagesen etj.

Këto bisedime e kanë karakterin e parapërgatitjes rreth lidhjes së kontrates.Në këtë fazë të bisedimeve,palët nuk janë në detyrim ndaj njera tjetrës.Negociatat i paraprijnë lidhjes së kontrates dhe nuk obligojnë. (*Goirovki-Tripinovska, 1997*)

Oferta është propozim për lidhjen e kontrates që i bëhet personit të caktuar e cila përmban të gjitha pjesët përbërëse esenciale të kontrates,kështu që me pranimin e saj do të mund të lidhej kontrata.Oferta është deklarimi i njëanshem i vullnetit i drejtuar palës tjetër me qëllim të pranimit.Pala që bënë propozimin për lidhjen e kontratës quhet propozues ose ofrues.Iniciativa e saj për lidhjen e kontratës quhet propozim ose ofertë.Në qoftëse oferta i bëhet bashkëkontraktuesit të pranishem,bashkëkontraktuesi sipas rregullit duhet të shprehet për të menjëherë,në qoftëse e pranon,atëherë arrihet pëlqimi i vullneteve përkatesisht kontrata. (*Choudry & Herring, 2010*)

Oferta duhet t'i plotësoj këto kushte

***-Që të jete dhënë nga personi i cili ka për qëllim të lidhë kontraten(ofruesi)ose nga personi i autorizuar i tij.***

***-Ti përmbaj elementet thelbësore për lidhjen e kontratës,të cilen dëshirojnë ta lidhin.***

***-Të përmbaje qartë dhe seriozisht vullnetin e shprehur të propozuesit se dëshiron të lidhë kontrate në bazë të kushteve të propozuara. (Vermelle, 2019)***

Oferta nuk është kontratë. Oferta është shprehje e njëanshme e vullnetit të ofruesit, me anë të së cilës ai propozon lidhjen e kontratës sipas kushteve të cilat i ka parashtruar në ofertën e vet. (Vermelle, 2019)

Që të bëhet kontratë, i ofruari duhet ta paraqes mendimin e vet dhe ta pranojë ofertën. Pa pranimin e ofertës nga i ofruari nuk ka as lidhje të kontratës. Duhet dalluar ofertën kur i bëhet personit jo të pranishëm dhe personit të pranishëm. Konsiderohet se oferta i ofrohet personit të pranishëm jo vetëm kur palët gjenden në të njëjtin lokal, por edhe kur gjenden në lidhje të drejtëpërdrejtë me anën e mjeteve teknike të informimit. Parakontrata mund të ndodhë që palët, për ndonjë arsye të mos lidhin dot kontratën veçse në një kohë të mëvonshme. Në këtë rast ato mund të lidhin një kontratë paraprake, që ka për objekt lidhjen e kontratës më vonë. Parakontratën është kontratë e atillë me të cilën merret përsiper detyrimi që më vonë të lidhet. Në këtë mënyrë, nëpërmjet kontratës paraprake, palët marrin përsiper detyrimin që më vonë të lidhin midis tyre një kontratë të përcaktuar. Që të arrihet kontrata, palët duhet të pajtohen mbi pjesët esenciale të kontratës (essentialia negotii). Pjesët esenciale janë ato pa të cilat kontrata nuk mund të mirret me mend. Ato përfshijnë efektet ekonomike, që palët dëshirojnë të arrijnë ndërmjet kontratës. Palët në kuadrin e së drejtës imperative lidhin punë juridike për çka do që të dëshirojnë (Goirovki-Tripinovska, 1997).

Sa i përket interpretimit prvec rregullave të përgjithshme të interpretimit të kontratës, ekzistojnë edhe rregullat plotësuese.

Këto rregulla janë:

Gjatë interpretimit të kontratës duhet të përmbahemi domethëniet e bukfalet të shprehjeve të përdorura por duhet të vërtetohet qëllimi i përbashkët i palëve kontraktuese.

Nëse ndonjë kontratë ose ndonjë dispozitë e saj është e pakuptueshme, duhet bërë përpjekje që kontrata të ngel në fuqi dhe që kur të interpretohet të ketë ndonjë kuptim.

Nëse dispozitat e kontratës përbëhen nga fjale të cilat mund të ketë kuptim të ngushtë ose të gjerë, dhe nuk dihet me siguri se cilin kuptim palët e kanë parasysh, kontrata duhet të interpretohet në kuptimin e ngushtë. (Choudry & Herring, 2010)

Në qoftëse interpretohet kontrata me shpërblim, ajo duhet të interpretohet me synimin që të realizohen rregullat e drejtshmërisë në dhënien reciproke të palëve.



Në rast se kontrata është e lidhur sipas përmbajtjes që më përpara të shtypur ose kur kontrata ka qenë e përgaditur në ndonjë mënyrë tjetër dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në llogari të palës tjetër. (Vermelle, 2019)

Kontratat e tilla interpretohen në dëm të përpiluesit në bazë të rregullës që secili e bartë rrezikun e përdorimit të shprehjeve të dykuptimshem. (Vermelle, 2019)

### **2.3 Kushtet për vlefshmërinë e kontratës**

Në qoftë se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të vullnetit të palëve, vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë (Choudry & Herring, 2010). Megjithatë, do të jenë të vlefshme ujdite e njëkohshme gojore për elementet sekondare për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me përmbajtjen e saj, apo nëse nuk janë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma. Të vlefshme janë edhe marrëveshjet e njëkohshme gojore që i zvogëlojnë ose i lehtësojnë detyrimet e njëres ose të të dy palëve, në qoftë se forma e veçantë është parashikuar vetëm në interesin e palëve kontraktuese.

Kontrata, për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim është e vlefshme edhe pse nuk është lidhur në këtë formë, në qoftë se palët kontraktuese detyrimet i kanë përmbushur në tërësi ose në pjesën më të madhe që dalin nga kontrata, përveç nëse qartë del ndryshe nga qëllimi për të cilin është parashikuar forma. Në qoftëse kontrata është e pavlershme për shkak të qëllimit, ose është kundër parimeve kushtetuese të rregullimit shoqëror, dispozitave ligjore ose moralit shoqëror, gjykata mund ta refuzoj në tërësi ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj çka ka dhënë pala tjetër e mund të vendosë që pala tjetër atë që e ka marrë në bazë të kontratës së ndaluar t'ia dorëzojë komunes në territorin e së cilës ajo e ka selinë, vendbanimin ose vendqendrimin. Pasojat juridike paraqiten në rast se është kryer ekzekutimin e pjesshëm ose në tërësi i kontratës. (Ligji për SH S, nr. 02/L-17)

Kontratat e pavlefshme ndahen në: 1) kontrata nule dhe 2) kontrata të rrëzueshme.

Kontratat nule nuk prodhojnë efekt juridik, kurse nulitetin e një kontratë mund ta kërkojë çdo i interesuar. Kurdo që bëhet fjalë për nulitet gjykata ka kompetencë që për këtë të kujdeset sipas detyrës zyrtare, pavarësisht nga parashtrimet e palëve. (Vermelle, 2019)

Kontratat e rrëzueshme janë kontrata të cilat mund të konvalidohen. Kontrata të tilla konsiderohet kontrata e lidhur nga personi me aftësi të kufizuar, kontrata e cila me rastin e lidhjes ka pasur të meta të vullnetit apo kur diçka e tillë është parapa me dispozitë të veçantë ligjore. Ndryshe rastet kur nuk vlenë kontrata ndryshe quhen edhe kontratat e ndaluara.

Kontratat janë të ndaluara nëse është në kundërshtim me parimet kushtetuese, me dispozita ligjore, me normat e moralit shoqëror dhe me normat e dokeve të mira. (Nani, 2009)

Kontratat e ndaluara paraqiten në të drejtën e detyrimeve, në të drejtën ekonomike, reale, financiare, administrative, dhe në të drejtën e punës.

Rastet më të shpeshta të kontratave të ndaluara janë:

**A.** Sipas një rregulle tradicionale, merret se kontrata është e ndaluar kur lidhet midis avokatit dhe klientit, në të cilin avokatit i premtohet ti paguhet njëra pjesë e shumës të cilën pala e realizon nga ky kontest. (Nani, 2009)

**B.** Është e ndaluar kontrata që lidhet midis avokatit dhe klientit me të cilën avokati blen tërësisht ose pjesërisht gjenë kontestuese që është besuar atij në mbrojtje. (Vermelle, 2019)

**C.** Është e ndaluar kontrata që të lidhet midis avokatit dhe klientit, me të cilin avokati për shërbimet që ofron merr me tepër shpërblim, se që parashihet me tarifën që nxirret nga Oda e avokateve. (Ligji për SHS, nr. 02/L-17)

**D.** Është e ndaluar kontrata për dhënie të shumës së caktuar të parave ndërmjetsuesit për të lidhur kurore midis personave të caktuar. (Vermelle, 2019)

**E.** Është e ndaluar kontrata kur lidhet midis dy subjekteve, kur njeri subjekt i premtonte ndonjë dobi pasurore që pala tjetër të lidhë kurore. (Ligji për SHS, nr. 02/L-17)

**F.** Është e ndaluar kontrata kur lidhet midis dy subjekteve, kur njeri subjekt i premtonte dobi pasurore ose i jep subjektit femer me qëllim që të krijoj bashkësi ilegjitime. (Ligji për SHS, nr. 02/L-17)

**G.** Është e ndaluar kontrata e lidhur midis personave fizik dhe personave juridik civile, e cila ka për lëndë të kontratës sendet në përdorim të përgjithshëm, p.sh., rruget, liqejt, sheshet, mineralet etj. (Vermelle, 2019)

**H.** Është e ndaluar kontrata midis palëve kontraktuese kur njëra merr detyrim nga pala tjetër që të kryejë veprë penale. (Choudry & Herring, 2010)

Kontratat e ndaluara janë kontrata të pavlefshme. Pavlershmëria e tyre është relative ose absolute, varësisht nga fakti se çka cenojnë kontratat në rastin e lidhjes.

Nëse me lidhjen e kontratave cenohet interesi individual të palëve kontraktuese, kontrata është me pavalershmëri relative. Kur me lidhjen e kontratave cenohet interesi i përgjithshëm i shoqërisë, kontrata është me pavalershmëri absolute.

Anulimi i këtyre kontratave bëhet sipas detyres zyrtare në rast së është e pavalershme absolute, ose me iniciativen e palës së dëmtuar kur është pavalershmëria relative. Anulimi i këtyre kontratave krijon pasoja juridike. Këto pasoja shprehen në kthimin në gjendje të mëparshme. Kthimi mund të jetë i njëanëshem ose i dyanëshem. (Nani, 2009)

Në rast të pavalershmërisë së kontratës çdo palë kontraktuese është e detyruar t'ia kthej tjetrës, atë që e ka marrë në bazë të kontratës së tillë, por në qoftë se kjo nuk është e mundur, ose në qoftëse natyra e asaj që është përmbushur e kundërshton kthimin, do të jepet shpërblimi përkatës me para, sipas çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor, përveç se ligji nuk cakton diçka tjetër. (Vermelle, 2019)

## **2.4 Shkëputja e kontratës**

Në vendet ku dominon parimi i të drejtës në punë është i institucionalizuar edhe parimi që punëtorit nuk mund ti shkëputet kontrata e punës apo ti ndërpritet marrëdhënia e punës pa dëshirën e tij. Por legjislacionet e punës i kanë paraparë edhe rastet e shkëputjes së kontratës së punës edhe kundër dëshirës së tij, kur për këtë paraqiten rrethanat e caktuara.

(Choudry & Herring, 2010)

Sipas dispozitave të rregullores për ligjin themelor të punës në Kosovë, shkëputja e kontratës së punës mund të bëhet në disa mënyra: **1.** me rastin e vdekjes së punëtorit; **2.** me marrëveshje me shkrim në mes të punëtorit dhe punëdhënësit; **3.** në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punëtori, shkelje të detyrave të punës apo cenim të rregullave të disiplinës në punë; **4.** për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punëtorit; **5.** me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit; dhe **6.** sipas fuqisë ligjore.

Shkëputja e kontratës bëhet kur ekziston ndonjë nga shkaqet të cilat çojnë në rrëzueshmërinë e punëve juridike atëherë pason anulimi i saj, si rregull këtë duhet ta kërkojë para të cilës i janë cenuar interesat juridike me atë punë juridike. Pala kontraktuese në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkojë që kontrata të anulohet. Mirëpo bashkëkontraktuesi i kësaj palë

mund të kërkojë prej saj që në afatin e caktuar, por jo më pak se 30 ditë të deklarohet a i përmbahet kontratës apo jo sepse në të kundërtën do të konsiderojë se kontrata është anuluar. (Nani, 2009).

Shkaqet që çojnë në shkëputjen e punëve juridike janë:

- mungesa e zotësisë së veprimit,
- Mangesite e vullnetit të deklaruar dhe
- dëmtimi i pamasë.

Në ligj mund të parashihen edhe shkaqe tjera të cilat çojnë në shkëputjen e punëve juridike. (Nani, 2009).

## 2.5 Shkëputja e kontratës me marrëveshje të palëve

Karakteristikë kryesore të kjo formë e shkëputjes së kontratës së punës është pajtimi i vullnetit nga të dy palët. Marrëveshja për shkëputjen e kontratës së punës duhet patjetër të jetë me shkrim. Përfundimi i kontratës është një veprim që mund të ndodhë kur një kontratë mund të përfundojë me ligj para se të përmbushen detyrat kontraktuale. Palët mund të zgjedhin të përfundojnë kontratat për një sërë arsyesh, por jo të gjitha përfundimet e kontratave do t'i lejojnë ata të shpëtojnë nga përgjegjësia. (Vermelle, 2019)

Sidoqoftë, disa raste të përfundimit të kontratës do të rezultojnë në anulimin e kontratës në tërësi. Përfundimi i kontratave rregullohet nga ligjet e kontratave, që do të thotë se ligji mund të ndryshojë në varësi të shtetit tuaj dhe juridiksionit tuaj.

Siç u përmend më lart, ndërprerja e një kontrate nuk ju çliron automatikisht nga detyrimet tuaja sipas kontratës. Sidoqoftë, ka disa raste në të cilat zgjidhja e një kontrate do t'ju çlirojë nga detyrimet tuaja sipas kontratës. (LFK, nr. 2004/32)

Përfundimi i kontratës konsiderohet i ligjshëm kur ekziston një arsye e ligjshme për t'i dhënë fund kontratës para se të përfundojë performancën e një personi. Arsyet më të zakonshme për përfundimin e kontratës mund të përfshijnë:

- **Marrëveshja ndërmjet dy Palëve:** Kjo mund të duket e qartë, por arsyeja më e thjeshtë kur përfundimi i kontratës do të rezultojë në anulimin e përgjegjësive të dikujt nën kontratë, është kur të dy palët bien dakord për të përfunduar kontratën; (Nani, 2009)

- **Përbushja e Kontratës:** Pothuajse aq e thjeshtë sa e fundit, një kontratë natyrisht do të përfundojë kur të dy palët të përbushin detyrimin e tyre sipas kontratës përmes performancës; *(Nani. 2009)*
- **Pamundësia e Performancës:** Ndonjëherë, një kontratë mund të bëhet e pamundur për t'u kryer për shkak të një ngjarje të paparashikuar, pasi është bërë kontrata. Për shembull, një fatkeqësi natyrore mund ta bëjë të pamundur kryerjen e një kontrate duke parandaluar një palë të përbushë detyrimet e tyre. Shembulli klasik i pamundësisë për të justifikuar detyrimet e dikujt nën një kontratë, është aty ku një palë ishte kontraktuar për të pikturuar një shtëpi, por shtëpia u dogj para se partia të mund të kryente; *(Vermelle, 2019)*

**Rastet e gabimit, mashtrimit ose keqpërfaqësimit:** Nëse një kontratë ishte krijuar nën kushte që përfshijnë gabim, keqpërfaqësim ose mashtrim, kontrata mund të përfundojë, pasi ajo nuk ishte formuar sipas parimeve të shëndosha të kontratës; *(Ligji KDK, Ligji nr. 2004/3)*

- **Shkelja e kontratës:** Siç u përmend më lart, të dy palët kanë për detyrë të kryejnë një kontratë. Prandaj, nëse një palë nuk kryen detyrat e veta të kontratës, kontrata mund të përfundojë, dhe pala që nuk bën shkelje mund të jetë në gjendje të rikuperojë humbjet e shkaktuara nga shkelja. Shkeljet mund të ndodhin kur njëra palë nuk kryen detyrat e tyre, ju bllokun në përbushjen e detyrave tuaja, ose kur njëra palë shkel kushtet e kontratës; ose

**Marrëveshjet paraprake:** Ndërprerja e një kontrate mund të ndodhë nëse palët kishin formuar më parë një marrëveshje në lidhje me përfundimin e kontratës. Për shembull, kontrata mund të ketë përmbajë një dispozitë specifike ku përcaktohen kushtet në të cilat mund të përfundojë. Një dispozitë e tillë njihet si një "klauzolë e përfundimit", dhe është e zbatueshme nëse të dy palët bien dakord për termat e përfundimit. *(Ligji për BGJK, nr. 2/2004)*

Siç shihet, ekzistojnë arsye të ndryshme që një kontratë mund të përfundohet. Prandaj, është e rëndësishme që ta rishikoni kontratën në mënyrë të plotë dhe të siguroheni që të kuptoni plotësisht detyrat tuaja kontraktuale përpara nënshkrimit të marrëveshjes. Më tej, gjithashtu dëshironi të siguroni që kontrata është shkruar qartë, pasi një kontratë e shkruar dobët shpesh do të rezultojë në përfundimin e paligjshëm të kontratës para se të përfundojë. *(Ligji mbi MMF, nr. 10/84 )*

## 2.6 Shkeputja e kontrates ne menyre te njeaneshme

Një kontratë e njëanshme është një marrëveshje kontrate në të cilën një ofertues premton të paguajë pas ndodhjes së një akti të caktuar. Në përgjithësi, kontratat e njëanshme përdoren më shpesh kur një ofertues ka një kërkesë të hapur në të cilën ata janë të gatshëm të paguajnë për një akt të specifikuar (Vermelle, 2019). Një shembull i një kontrate të njëanshme është një kontratë e politikës së sigurimit, e cila zakonisht është pjesërisht e njëanshme. Në një kontratë të njëanshme, ofertuesi është pala e vetme me një detyrim kontraktual.

Kontratat e njëanshme specifikojnë një detyrim nga ofruesi. Në një kontratë të njëanshme, ofertuesi premton të paguajë për akte të specifikuar që mund të jenë kërkesa të hapura, të rastit ose opsionale për palët e tjera të përfshira. Kontratat e njëanshme konsiderohen të zbatueshme me ligjin e kontratave. Sidoqoftë, çështjet ligjore zakonisht nuk lindin derisa ofertuesi pretendon se ka të drejtë për shpërbllim të lidhur me akte ose dukuri. Si e tillë, kontestimi juridik zakonisht përfshin rastet kur pala ofruese nuk pranon të paguajë shumën e ofruar. (Nani, 2009) Përcaktimi i shkeljes së kontratës do të varet nga fakti nëse kushtet e kontratës ishin apo jo të qarta dhe nëse mund të vërtetohet se ofertuesi ka të drejtë për pagesa të akteve të përcaktuara bazuar në dispozitat e kontratës. (Vermelle, 2019)

Si shembull marrim kontratën e qiras:

Përfundimi i njëanshëm i qirasë është një tjetër mundësi e përfundimit të marrëveshjes së qirasë dhënë nga arti. 1816 të Kodit Civil (Nani, 2009). Sipas kësaj dispozite, përfundimi i kontratës gjithashtu mund të deklarohet në mënyrë të njëanshme nga pala e drejtuar me njoftim me shkrim kur plotësohen një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

- palët janë pajtuar kështu;
- pala tjetër konsiderohet si paracaktuar automatikisht;
- pala tjetër nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit të caktuar nga vonesa;

Në rast të kontratave me përmbarrim të njëpasnjëshëm ose të vazhdueshëm, nëse e drejta e përfundimit të njëanshëm "është njohur nga njëra nga palët", ajo mund të jetë objekt ekzekutimi i ndjekur nga një periudhë e arsyeshme e njoftimit. Është shumë e rëndësishme të përmendet që përfundimi i njëanshëm në këtë rast nuk ka efekt mbi pjesën e ekzekutuar tashmë të marrëveshjes. Marrëveshja e lidhur për një periudhë të pacaktuar kohe mund të përfundojë në mënyrë të njëanshme nga secila palë, në varësi të një periudhe kohe të arsyeshme të njoftimit. Me miratimin e këtij rregulli të përgjithshëm, "nëse qiraja është bërë pa përcaktuar kohëzgjatjen, secila palë mund

ta ndërpresë kontratën me njoftim". Kështu, si përjashtim nga zgjidhja e kontratës me pëlqim të ndërsjellë, qiraja mund të pushojë gjithashtu duke manifestuar vullnetin e një pale të vetme (dhe cilindo). (OSBE, 2011)

Përjashtimi i lartpërmendur nuk zbatohet në rastin kur palët nuk e përcaktuan kohëzgjatjen e marrëveshjes së qirasë, por në të njëjtën kohë ata nuk kanë ndërmend të lidhin marrëveshjen për një periudhë të pacaktuar kohore. Sidoqoftë, kjo situatë është e rregulluar në art. 1785 i Kodit Civil i cili parashikon qartë që qiraja përfundon: për një vit, në rast të banesave të palejuara ose ambienteve për veprimtarinë e një profesionisti; për kohëzgjatjen për të cilën u llogarit qiraja, në rastin e pasurisë së luajtshme ose të dhomave ose apartamenteve të mobiluara; gjatë periudhës së qirasë së pasurive të paluajtshme, në rastin e pasurive të luajtshme të vëna në dispozicion të qiramarrësit për përdorimin e një ndërtese (Nani, 2009).

Duhet të theksohet se e drejta për të përfunduar në mënyrë të njëanshme të kontratës është një klauzolë jo standarde sipas artit. 1203 të Kodit Civil, që do të thotë se klauzola do të ketë efekt vetëm përderisa kjo klauzolë pranohet shprehimisht me shkrim nga pala tjetër kontraktuese (Nani, 2009). Nëse klauzola e përfundimit të njëanshëm të kontratës nuk u pranua shprehimisht nga pala tjetër kontraktuese, ajo klauzolë nuk do të jetë efektive. Kontratat e njëanshme janë kryesisht njëanshme pa një detyrim të rëndësishëm nga ofertuesi. Kërkesat e hapura dhe policat e sigurimit janë dy nga llojet më të zakonshme të kontratave të njëanshme. Kontratat e njëanshme janë kryesisht njëanshme pa një detyrim të rëndësishëm nga ofertuesi. Kërkesat e hapura dhe policat e sigurimit janë dy nga llojet më të zakonshme të kontratave të njëanshme (OSBE, 2011).

### **Kërkesa të hapura**

Në ekonominë e hapur, ofruesit mund të përdorin kontrata të njëanshme për të bërë një kërkesë të gjerë ose opsionale e cila paguhet vetëm kur përmbushen specifikime të caktuara. Nëse një individ ose individë përmbushin aktin e specifikuar, ofertuesi është i detyruar të paguajë. (Ligji për SHS, nr. 02/L-17)

Shpërblimet janë një lloj i zakonshëm i kërkesës së njëanshme të kontratës. Në çështjet penale, një shpërblim mund të jetë i disponueshëm për informacion të rëndësishëm të dhënë për rastin. Fondet e shpërblimit mund t'i paguhet një individ të vetëm ose disa individëve që ofrojnë informacion që plotëson kriteret e specifikuar. (Goirovki-Tripinovska, 1997)

## **Sigurim**

Policia e sigurimeve kanë karakteristika të njëanshme të kontratës. Në rastin e një kontrate sigurimi, siguruesi premtan të paguajë nëse akte të caktuara ndodhin nën kushtet e mbulimit të një kontrate. Në një kontratë sigurimi, ofertuesi paguan një premium të specifikuar nga siguruesi për të mbajtur planin dhe për të marrë një ndarje të sigurimit nëse ndodh një ngjarje e caktuar. *(Ligji për pronësi, nr. 03/L-154)*

Kompanitë e sigurimeve përdorin probabilitetin statistikor për të përcaktuar rezervat e nevojshme për të mbuluar pagesat e klientëve që ata sigurojnë. Disa raste sigurimesh nuk mund të përfshijnë kurrë një dukuri që çon në përgjegjësi nga siguruesi ndërsa rastet ekstreme kërkojnë nga kompania e sigurimeve të paguajë shuma të mëdha parash për një dukuri të mbuluar në planin e sigurimit të një klienti.

## **2.7 Shkëputja e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave(klauzola rebus six stantibus)**

Në qoftë se pas lidhjes së kontratës krijohen rrethanat që e vështirësojnë përmbushjen e detyrimit të njëres palë, apo në qoftë se për shkak të tyre nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës, e si në njërin, ashtu edhe në rastin tjetër në atë masë sa që del e qartë se kontrata nuk i përgjigjet më asaj që është pritur nga palët kontraktuese dhe se sipas vlerësimit të përgjithshëm do të ishte e padrejtë të mbahet në fuqi e tillë siç është, pala të cilës i është vështirësuar përmbushja e detyrimit, përkatësisht pala e cila për shkak të rrethanave të ndryshuara nuk mund ta realizojë qëllimin e kontratës, mund të kërkojë që kontrata të zgjidhet apo të ndryshohet. *(Ligji për BGJK, nr. 2/2004)*

Zgjidhja e kontratës nuk mund të kërkojë në qoftë se pala thirret në rrethana të ndryshuara, ka pasur për detyrë që në kohën e lidhjes së kontratës të marrë në konsiderim këto rrethana ose ka mundur që këto t'i evitojë apo t'i përballojë. *(Vermelle, 2019)*

Pala që kërkon zgjidhjen e kontratës nuk mund të thirret në rrethana të ndryshuara që janë shkaktuar pas skadimit të afatit të caktuar për përmbushjen e detyrimit të saj.



Kontrata nuk do të zgjidhet në qoftë se pala tjetër ofron ose pranon që kushtet përkatëse të kontratës të ndryshohen në mënyrë të drejtë. *(LKDK, nr. 2004/3)*

Në qoftë se është deklaruar zgjidhja e kontratës, gjykata me kërkesë të palës tjetër, do ta detyrojë palën që e ka kërkuar zgjidhjen të shpërblejë palës tjetër pjesën e dëmit të caktuar në mënyrë të drejtë, të cilën e pëson për këtë. Pala që është e autorizuar, që për shkak të ndryshimit të rrethanave të kërkojë zgjidhjen ose ndryshimin e kontratës, ka për detyrë që për qëllimin e saj ta njoftojë palën tjetër, posa të këtë mësuar se janë shkaktuar rrethanat e tilla. Në qoftë se këtë nuk e bën, përgjigjet për dëmin që ka pësuar pala tjetër për shkak se kërkesa nuk i është komunikuar me kohë. Kur vendos për zgjidhjen e kontratës, përkatësisht për ndryshimin e saj gjykata udhëhiqet nga parimet e qarkullimit të ndershëm, duke pasur kujdes sidomos për qëllimin e kontratës, për rrezikun e zakonshëm të kontratës e llojit përkatës, për interesin e përgjithshëm, si dhe për interesat e të dy palëve. Palët mundën me kontratë që më parë të heqin dorë nga e drejta për tu thirrur në rrethanat përkatëse të ndryshuara, përveç nëse kjo është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë. *(Vermelle, 2019)*

## **2.8 Shkeputja e kontrates kur afati është element esencial i kontrates**

Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar është element thelbësor i kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet sipas vetë ligjit. *(Vermelle, 2019)*

Kreditori mund ta mbajë kontratën në fuqi, në qoftë se pas skadimit të afatit, pa shtyrje e njofton debitorin se kërkon përmbushjen e kontratës.

Kur kreditori e ka kërkuar përmbushjen, por kjo nuk është realizuar brenda afatit të arsyeshëm, mund të deklarojë zgjidhjen e kontratës.

Këto rregulla vlejné si në rastin kur palët kontraktuese kanë parashikuar që kontrata të konsiderohet e zgjidhur në qoftë se nuk do të përmbushet brenda afatit të caktuar, ashtu edhe kur përmbushja e kontratës brenda afatit të caktuar është element thelbësor i kontratës sipas vetë natyrës së punës. *(Nani, 2009)*

Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar nuk është element thelbësor i kontratës, debitori mban të drejtën që edhe pas skadimit të afatit ta përmbushë detyrimin e tij, kurse kreditori të kërkojë përmbushjen e saj.

Në qoftë se kreditori dëshiron ta zgjidhë kontratën duhet detyrimisht t'i lejë debitorit një afat të ri të përshtatshëm për përmbushjen e detyrimit.

Në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të ri krijohen të njëjtat pasoja sikurse kur afati është element thelbësor i kontratës. *(Ligji për SHS, nr. 02/L-17)*

Kreditori mund ta zgjidhë kontratën pa i lënë debitorit afat të ri për përmbushjen e detyrimit në qoftë se nga qëndrimi i debitorit del se ai detyrimin e tij nuk do ta përmbushë as në afatin e ri. Kur para skadimit të afatit për përmbushjen e detyrimit del e qartë se njëra palë nuk do ta përmbushë detyrimin e saj nga kontrata, pala tjetër mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë shpërblimin e demit. *(Choudry & Herring, 2010)*

## **2.9 Pasojat juridike të shkëputjes së kontratës**

Shpërblimi I demit si pasoje e mospërmbushjes së kontratës

Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). *(Nani, 2009)*

Kur kemi të bëjmë me kërkesën për kompensim të demit material, duhet pasur parasysh parimin se ai që ban përgjegjesi për demin e shkaktuar, kurdo që është e mundur, në rënd të parë ka përgjegjesi që ta kthejë në gjendjen e mëparshme. Kompensimi në të holla gjë shprehje atehere kur kthimi në gjendje të mëparshme nuk është i mundur. Gjithashtu kompensimi në të holla vë në shprehje kur gjykata gjë se për shkaqe të arsyeshme kthimi në gjendje të mëparshme nuk është i dobishëm. Dëmi material – Me dem material kuptojmë demin e zakonshëm i cili aty për aty manifestohet dhe mund të konstatohet. Poashtu me dem material kuptojmë edhe demin i cili shprehet si fitim i humbur dhe si zvogëlim i mundësisë për rritjen e pasurisë. Vertetimi i vlerës së demit të shkaktuar është çështje e cila varet nga rrethanat vë e vë. *(Vermelle, 2019)*

Demtimi pasuror ne rast te vdekjes, lendimit trupor ose demitmit te shendetit - Kur si pasoje e nje veprimi paraqitet vdekja e dikujt, atehere ai person ka per detyre qe ti kompensoj shpenzimet e varrimit dhe shpenzimet lidhur me varrimin. Vdekja e dikujt eshte baze per demshperblim per personat te cilet ai I ka mbajtur. Ne rastet e ketilla gjykohet renta. (*Ligji për BGJK, Ligji. nr. 2/2004*)

Baze per kerkese per demshperblim pasuror eshte edhe lendimi trupor dhe shkaterrimi i shendetit. Per keto raste njihet e drejta per demshperblim pasuror per mjekim dhe lidhur me mjekim, per fitim te humbur per shkak te pamundesise qe te punohet, si dhe te drejten e rentes kur si pasoje e demtimit te shendetit paraqitet pamundesia qe te fitohet sa eshte fituar me pare (*LKDK, nr. 2004/3*). Demshperblimi jomaterial (moral) – Kur kemi te bejme me demet jomateriale (morale), parimi i kthimit te gjendjes se meparshme eshte i pamundur ose paraqet perbushje jo te plote. Per kete arsye e drejta e detyrimeve parasheh dy mundesi:

**1.** Publikimin e aktgjykimit ne mjete te informimit ose urdherin qe te terhiqet deklarata me te cilen eshte shkaktuar cenimi,

**2.** Detyrimin e shkaktuesit te demit qe te paguaj nje hsume te hollave si satisfaksion per pasoja te demshme te shkaktuara nga dhembjet fizike, cenimi i rpestigjit, cenimi i nderit, te lirive dhe te drejtave te njeriut dhe dhembjeve shpirtore te shkaktuara me vdekjen e personit te aferm. Vdekja e personit te aferm eshte baze per demshperblim vetem per anetaret e ngushte te familjes (bashkshortin, prinderit, femijet).

Pergjegjesia e me shume personave per te njejtin dem (pergjegjesia solidare). Kjo pergjegjesi parashihet edhe per ndihmesin edhe per nxitesin e personit i cili ka shkaktuar dem, si dhe per ata qe kane vepruar pavaresisht nga njeri tjetri (*OSBE, 2011*).

Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit. Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit. (*Choudry & Herring, 2010*)

**1.** Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.

2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. (*Ligji për BGJK. Nr. 2/2004*)

3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.

4. Gjkata do t'ia gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. (*Sammut, I, University of Malta*)

### **2.9.1 Mënyra se si përlogaritet dëmi kontraktues**

Formulimi ligjor thot: “kush tjetrit i shkakton dëm, ka për detyrë t'ia kompensoj, nëse nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij” (*Ligji për BGJK Nr. 2/2004*).

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar pavarësisht nga faji parashihet edhe në disa raste të tjera. Përgjegjësia në bazë të fajit – për të ekzistuar përgjegjësia e dikujt që një dëm të shkaktuar ta kompensoj nga baza e fajit, duhet që dëmi të jetë shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia.

Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. (*LKDK, nr. 2004/3*)

Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. (*Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, nr. 03/L-154*)

Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj. Përgjegjësia për personin tjetër – për këtë lloj përgjegjësie ligji përfshin rastet kur dëmi shkaktohet nga personat me sëmundje mentale ose me të meta mentale, përgjegjësinë e prindit për dëmin e shkaktuar nga fëmiju i tij, përgjegjësinë solidarë, përgjegjësinë e personave tjerë për të mitur. (*Choudry & Herring, 2010*).

Kur është fjala për përgjegjësinë e organizatës punuese, atëherë duhet që personi i cili e ka shkaktuar dëmin të ketë cilësinë e punëtorit, që punëtori të shkaktoj dëmin me veprim që i përgjigjet punës se tij, që dëmi të mos jetë i shkaktuar nga sendi apo veprimtaria e rrezikshme. Përgjegjësia për dëm nga sendi i rrezikshëm ose veprimtaria e rrezikshme. Pavarësisht nga përcaktimi ligjor mbi përgjegjësinë e pronarit të sendit të rrezikshëm apo veprimtarisë së

rrezikshme , për dëmin e shkaktuar nga sendi apo veprimtaria e rrezikshme parashihen edhe mundesitë e lirit nga kjo përgjegjësi. (*Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, Ligji nr. 03/L-154*).

Pra pronari i sendit apo i veprimtarisë së rrezikshme mund të lirohet nga përgjegjësia nëse provon se:

-dëmi është shkaktuar nga një shkak i cili është jashtë sendit apo veprimtarisë së rrezikshme, kurse ai veprim nuk ka mundur të parashihet, të largohet apo evitohet kur dëmi është shkaktuar nga vetë i dëmtuari -kur dëmi është shkaktuar nga i treti. Përgjegjësia në rast të ndeshjes së automjeteve – në këto raste ligji parasheh rregulla të veçanta të përgjegjësisë. Kur ndeshja ndodh me fajin ekskluziv të njerit , atëherë aplikohen rregullat e parapara për përgjegjësi në baza të fajit. Mirëpo kur faji është reciprok, atëherë secili përgjigjet për dëmin në përpjestim me shkallën e fajit. Kur ndeshja shkaktohet pa fajin e asnjërit, ata përgjigjen në pjesë të barabarta. Përgjegjësia për sendet me të meta kur kemi të bëjmë me përgjegjësinë për sendet të cilat prodhuesi I ve në qarkullim, ndërsa prodhimi për shkak të ndonjë të metë për të cilën nuk është ditur paraqet rrezik për sende ose njerëz, përgjegjësia për dëmin trajtohet si e shkaktuar nga ai send, respektivisht prodhim.

Afati i caktuar në ditë fillon të rrjedhë ditën e parë pas ngjarjes nga e cila mund të llogaritet afati, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit, të afatit (*Ligji për SHS, nr. 02/L-17*).

Afati i caktuar në javë, muaj ose vite përfundon atë ditë që me emër dhe numër përputhet me ditën e lindjes së ngjarjes nga e cila ka filluar të rrjedhë afati; e në qoftë se një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit bie në ditën e fundit të atij muaji.

Në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditën kur në bazë të ligjit është caktuar që të mos punohet, si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e parë e punës në vijim.

Fillimi i muajit shënon ditën e parë të muajit, mesi i muajit me pesëmbëdhjetë (15) të muajt, dhe fundi i muajit në ditën e fundit të muajit, në qoftë se diçka tjetër nuk rezulton nga qëllimi I palëve, nga natyra e marrëdhënies, ose nga doket. (*LKDK, nr. 2004/3*)

### **2.9.2 Fitimi I munguar(humbur) si pasojë e mospërmbushjes së kontratës**

Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim (OSBE, 2011).

I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër.

Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin (Choudry & Herring,2010).

Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin. Sa i perket zvoglimit të shpërblimit Gjykata mundet, duke pasur kujdes për gjendjen materiale të të dëmtuarit, ta gjykojë personin përgjegjës ta paguajë shpërblimin më të vogël nga shuma e dëmit, në qoftë se dëmi nuk është shkaktuar as me dashje e as nga pakujdesia rende, ndërsa personi përgjegjës është në gjendje të rende materiale, kështu që pagimi i shumës së plotë do ta sjellte në *skamje* (Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, Ligji nr. 03/L-154).

Në qoftë se dëmtuesi ka shkaktuar dëm duke punuar diç për dobi të të dëmtuarit, gjykata mund të caktojë shpërblim më të vogël, duke pasur parasysh kujdesin që tregon dëmtuesi në punët vetjake. Përgjegjësia ndahet në keto menyra:

- 1.** I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar (Choudry & Herring ,2010).
- 2.** Për paragrafin paraprak vihen përshtatshëmrisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin.
- 3.** Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit (OSBE, 2011)
- 4.** Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij (LKDK, nr. 2004/3).

Humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe te varrosjes behen nga kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij. Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë. Ndersa sa u perket te drejtave te personit te cilin e ka ushqyer i vdekuri personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte I dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetet gjallë (*Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, nr. 03/L-154*)

### **3 DEKLARIMI I PROBLEMIT**

Gjatë hulumtimit, është parë se nuk ka shumë literaturë që kanë fokus kryesor kontratat dhe përmbajtjen e tyre të saktë në mënyrë të informimit të qytetareve në shmangien e pasojave juridike. Bazuar në literaturën e më lartë, interpretimi I kontratave ka ndikim të rëndësishëm në kualitetin, kuptimin dhe çartësin e kontratave tek palët. Nga materiali I lartëpërmendur kemi cekur që gjatë interpretimit të kontratës duhet të përmbahemi domethënieve bukfale të shprehjeve të përdorura por duhet të vërtetohet qëllimi i përbashket i palëve kontraktuese. Është supozuar se interpretimi duhet të jetë i tillë që t'i përgjigjet përmbajtjes, natyres, lëndes dhe karakteristikave të kontrates. se kontrata është lidhur në formë të veçantë, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të vullnetit të palëve, vlen vetëm ajo që është shprehur në këtë formë.

Legjislacionet e punës i kanë paraparë edhe rastet e shkëputjes së kontratës së punës edhe kundër dëshirës së tij, kur për këtë paraqiten rrethanat e caktuara. Në ligj edhe shkaqe tjera të cilat çojnë në shkëputjen e punëve juridike. Marrëveshja për shkëputjen e kontratës së punës duhet patjetër të jetë me shkrim. Përfundimi i kontratës është një veprim që mund të ndodhë kur një kontratë mund të përfundojë me ligj para se të përmbushen detyrat kontraktuale.

Kurse pyetja themelore hulumtuese që është parashtruar në këtë punim adreson identifikimin e pasojave më të mëdha që e ndikojnë më së shumti në vlershmërinë e kontratës dhe në kujdesin që të mos ketë pasoja juridike si dhe ndryshimet që mund të ndodhin në kontratë me pajtueshmërinë e palëve. Kur vendos për zgjidhjen e kontratës, përkatësisht për ndryshimin e saj gjykata udhëhiqet nga parimet e qarkullimit të ndershëm, duke pasur kujdes sidomos për qëllimin e kontratës, për rrezikun e zakonshëm të kontratës e llojit përkatës, për interesin e përgjithshëm, si dhe për interesat e të dy palëve.



## 4 METODOLOGJIA

Kontrata është burimi kryesor dhe më i rëndësishëm i marrëdhënieve të detyrimeve. Kontrata është marrëveshje e dy apo më shumë personave që ka për qëllim

1. Të krijoj
2. Të ndryshojë ose
3. Të shuaj një marrëdhënie juridike të detyrimit.

Kontrata hyn në grupin e punëve juridike të dyanshme. Me anën e kontratës krijohet detyrimi i ri, ndryshohet marrëdhënia ekzistuese e detyrimit, përkatësisht me anën e saj shuhen detyrimet. Me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet e pjesëmarrësve në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve. Me anë të kontratës bëhet si qarkullim i brendshëm, ashtu edhe ndërkombëtar i mallërave. Me anë të kontratës bartet pronësia, kurse në disa të drejta të tjera ajo është bazë për kalimin e pronësisë. Terminologjia e kontratës lidhur me përcaktimin e kontratës nuk është unike sepse përveç termint kontratë përdoren edhe termat si: Konvente, Traktat, Pakt, Dakordim, Marrëveshje.

Termi konventë përdoret në marrëdhëniet ndërmjet shteteve ku lidhen konventat e ndryshme për rregullimin e çështjeve midis dy apo më shumë shteteve. Marrëveshja është term i cili përdoret në kuptimin e ngushtë, që të shënojë edhe bisedimet që paraprijnë lidhjes së kontratës. Me traktat ndërkombëtar konsiderohet çdo pajtim i vullnetit ndërmjet shteteve me qëllim të krijimit, ndryshimit ose ndërprerjes së ndonjë raporti juridik reciprok ose marrëveshje e karakterit kontraktual ndërmjet shteteve ose organizatave të shteteve me të cilat krijohen të drejtat dhe detyrimet për palët. Dakordimi është shprehje që përdoret për të përcaktuar se palët janë pajtuar për ndonjë pjesë të kontratës ose për ndonjë dispozitë të saj që ka qenë e paqartë.

## **5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE**

### **5.1 Prezantimi I rezultateve**

Parimet themelore të së drejtës kontraktore janë: Parimi i lirisë së kontraktimit dhe Parimi i konsensualizimit. Liria e kontraktimit është njeri ndër parimet themelore të së drejtës kontraktore. Parimi i lirisë së kontraktimit paraqet mundësinë për pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit që me vullnetin e tyre të lirë t'i rregullojnë marrëdhëniet reciproke juridike të detyrimeve.

Parimi i lirisë së kontraktimit do thotë: Që çdo subjekt i së drejtës të vendosë lirisht, të nlihdë ose të mos lidh kontratën e caktuar. Që çdo subjekt i së drejtës të zgjedh lirisht personin me të cilin do lidh kontratën. Që subjektet e së drejtës të caktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës, formën dhe mënyrën e lidhjes së saj. Që subjektet e së drejtës të vendosin lirisht mbi ndërrimin dhe mënyrat e shuarjes së kontratës. Në rastet se kontrata lidhet ndërmjet subjekteve me shtetësi të ndryshme, subjektet e së drejtës mund të zgjedhin lirisht legjislacionin i cili do të zbatohet në kontratën e tyre, si dhe të caktojnë gjykatën në rast kontesti ndërmjet palëve. Përmbajtja e kontratës caktohet lirisht nga palët kontraktuese, kur caktohet, ajo ka vlerën e ligjit për palët.

### **5.2 Analiza e rezultateve**

Fusha e zbatimit të kontratës është e gjerë. Kontratat zbatohen gati në të gjitha degët e së drejtës, përveç të drejtës penale. Në të drejtën e punës kontratat gjejnë shprehje në marrëdhëniet rreth punës, në kontratat kolektive të punës. Në të drejtën ekonomike më së shumti zbatohet kontrata për qarkullimin e mallërave dhe për kryerjen e shërbimeve. Në të drejtën ndërkombëtare publike me anë të kontratës rregullohen marrëdhëniet midis shteteve. Në të drejtën financiare kontratat zbatohen në rregullimin e transaksioneve të ndryshme financiare. Kontratat më së shumti zbatohen në të drejtën e detyrimeve.

## 6 KONKLuzionet

Në bazë të shtjellimit të Kontratave dhe llojeve të tyre, kemi arritur në një konkludim që nga të gjitha kontratat, në vendet ku dominon parimi i të drejtës në punë është i institucionalizuar edhe parimi që punëtorit nuk mund ti shkëputet kontrata e punës apo ti ndërpritet marrëdhënia e punës pa dëshirën e tij. Sipas dispozitave të rregullores për ligjin themelor të punës në Kosovë, shkëputja e kontratës së punës mund të bëhet në disa mënyra të cilat janë lartepërmendur në materialin e shqyrtuar.

Punimi i kësaj teme është produkt i njohurive të fituara gjatë studimeve për llojet e kontratave dhe llojet e arsytet e shkeputjes së tyre dhe proceset që në çfarë procedurë kalojnë palet e nënshkruar poashtu edhe motivimi nga mentori im për të hulumtuar për më tepër rreth materialit në vendin tonë konkretisht në baze të ligjeve të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës dhe materialet e pafundme të kontratave dhe mos zbatimi i tyre me llojllojshmerinë e shkeputjeve të ben procesin e zhvillimit të materialeve sfidues e njëkohësisht interesant.

Gjatë këtij hulumtimit të kësaj teme, kam gjetur njohuri të pafundme rreth kontratave si dhe cka na prë përpara dhe pas nënshkrimit të tyre.

Në përfundim, duke u bazuar në konkluzionet e dalura nga ky studim, do të jepnim mendimin se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të barabartë. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve detyrohen

të veprojnë me kujdesin që kërkohet në qarkullimin juridik të llojit përkatës të marrëdhënies së detyrimit (kujdesi i një ekonomisti të mirë ose kujdesi i një shtëpiaku të mirë). Në përmbushjen e detyrimeve të tyre nga veprimtaritë profesionale, pjesëmarrësit në

marrëdhëniet e tyre të detyrimeve duhet të veprojnë me kujdes të lartë, sipas rregullave dhe zakonet të profesionit (kujdesi i një eksperti të mirë). Cdo person fizik dhe juridik apo cdo pjesëmarrës në raportin konkret ka cilësinë e subjektit të detyrimeve. Raporti detyrimor është; raport juridik; raport në mes të subjekteve të caktuara; raport i cili përmban kërkesë për detyrim; raport i cili ka për objekt një të mirë; raport me karakter pasuror; raport në harmoni me ligjin.

Ky studim propozon një mënyrë të thjeshtë, që të gjitha institucionet t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe punëve juridike në përgjithësi dhe sidomos pasojave të saj, në raste të mos përmbushjeve të tyre.

## 7 REFERENCAT

### Referencat parësore

Vermelle, Georges, (2019) , *E drejta civile, Kontratat, Pjesa e posaçme.*

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, nr. 90/62 të datës 08.05.2003

Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 10/84

Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji nr. 2004/32

Nani, Ardian, *E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme*, Tiranë 2009

Sammut, I, “Family Law in the EU’s Acquis Communautaire: Where is it Going?”, University of Malta

OSBE, Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë: Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve, 2011

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, Ligji nr. 03/L-154

Ligji për shërbime sociale dhe familjare i Kosovës, Ligji nr. 02/L-17

Goirovki-Tripinovska Liljana, *Cemejeno pravo NIP Studensk izbor*, Skopje 1997

28. Guyisaac-Marc, Blamquet, *Modern Family Law - cases and materials* Laë Aspen Law&Business, New York, 1998

Ligji kundër diskriminimit i Kosovës, Ligji nr. 2004/3

Ligji për barazi gjinore i Kosovës, Ligji. Nr. 2/2004

European Parliament “Citizen’s Rights and Constitutional Affairs –Which basis for Family Law? The Way Forward” Note from the European Parliament, 2012

Choudry & Herring, “European Human Rights and Family Law”, Bloomsbury UK, 2010

### Referencat dytësore

<http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-e-punes/leksione/shkeputja-e-kontrates-se-punes-nderprerja-e-marredhenies-se-punes.html>

<https://bks->

[ks.org/static/uploads/documents/Ligji%20per%20marredheniet%20e%20detyrimeve.pdf](https://bks-ks.org/static/uploads/documents/Ligji%20per%20marredheniet%20e%20detyrimeve.pdf)